



**RAPORTI I KOMISIONIT PËR ZHVILLIMIN E DISKUTIMIT PUBLIK PËR  
PLANIN RREGULLUES TË HOLLËSISHËM PË ZONËN TE FAKULTETI TEKNIK  
NË LAGJEN “BREGU I DIELLIT”**

Shqyrtimi i vërejtjeve dhe komenteve të qytetarëve për Planin Rregullues të  
Hollësishëm për “Zonën e Fakultetit Teknik, në lagjen Bregu i Diellit

Prishtinë  
dt. 06.10.2020





**Raporti i komisionit të caktuar me Vendimin e Kryetarit të Komunës së Prishtinës 14-020/04-166487/2 më 16.09.2020 "Për zhvillimin e diskutimit publik për planin rregullues të hollësishëm për zonën te fakulteti teknik në lagjen "Bregu i Diellit"**

Sipas pikës III të këtij vendimi "detyrë e komisionit është që të kujdeset për zhvillimin e diskutimit publik sipas UA MMPH-Nr.05/2014 për përgjegjësitë e autoriteteve të Planifikimit hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapësinor si dhe sipas UA MAPL-NR.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në komuna".

Kuvendi i Komunës së Prishtinës ka iniciuar hartimin e këtij plani me Vendimin 01-350/01-0026729/19 më 06.02.2019 Kuvendi i Komunës së Prishtinës "Për fillimin e hartimit të planit rregullues të hollësishëm për zonën te fakulteti teknik në lagjen "Bregu i Diellit" me qëllim të orientimit të investimeve publike për nevojat e universitetit, për përmirësimin e infrastrukturës dhe rigjallërimin e zonës, çështjet mjedisore dhe zhvillimet e njësive të planifikuara etj.

Sipas Planit Zhvillimor Komunal të miratuar nga Kuvendi Komunal me vendimin nr.01-031-156871 dt.27.08.2013, kjo zonë është e destinuar si zonë ekzistuese urbane dhe po ashtu sipas Planit Zhvillimor Urban të miratuar nga Kuvendi Komunal me vendimin nr.035-181427 dt.24.09.2013 kjo zonë është e destinuar si hapësira me përmbajtje publike – opera dhe universiteti.

Plani Rregullues i Hollësishëm për këtë zonë është hartuar nga Universiteti "Hasan Prishtina", ekspertët e Fakultetit të Arkitekturës në koordinim me Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Me dt.11.11.2019 në orën 18:00, Komuna e Prishtinës dhe Universiteti i Prishtinës në sallën e Modelariumit të fakultetit të Arkitekturës, kanë mbajtur prezantimin e këtij plani të propozuar dhe është diskutuar me qytetarët pjesëmarrës në këtë takim. (Komisionit nuk i është prezantuar procesverbali dhe lista e pjesëmarrësve).

Shqyrtimi publik i propozim planit është zhvilluar nga data 04.02.2020 deri më 03.03.2020 në hapësirat e objektit të komunës, pranë Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, në bazë të Vendimit të Kuvendit të Komunës 01-350/05-315010/19 më dt. 30.12.2019 "për Lënie në Shqyrtim Publik të Projekt Dokumentit të Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën te Fakulteti Teknik në lagjen "Bregu i Diellit"

Me që komisioni është caktuar më 16.09.2020 pas zhvillimit të aktiviteteve të lartë shënuara, komisioni punën e vet e përkufizon në shqyrtimin e vërejtjeve dhe komenteve për Planin Rregullues të Hollësishëm për "Zonën e Fakultetit Teknik, në lagjen Bregu i Diellit" të pranuar dhe të evidentuara në librin e vërejtjeve gjatë kohës së shqyrtimit publik.

Në listën e vërejtjeve, propozimeve, sugjerimeve dhe kërkesave janë evidentuar gjithsej 8 (tetë) ku dy nga to janë në formë peticioni të grupeve të qytetarëve. Vërejtjet dhe sugjerimet e qytetarëve kryesisht kanë të bëjnë me kërkesën që kjo hapësirë të destinohet si park për nevojat e qytetarëve të lagjeve për rreth dhe më gjerë, dhe me theks të veçantë për hapësirën e propozuar për ndërtimin e objektit T6 – FIEK dhe FIM.

Komisioni i konsideron të pranueshme kërkesat e qytetarëve që hapësira e planifikuar T6 të mbetet hapësirë e lirë rekreative dhe propozon që objekti T6 – FIEK dhe FIM të dislokohen në hapësirën mbi, përball objektit ekzistues - fakultetit teknik, gjithnjë duke respektuar normat teknike dhe udhëzimet administrative në fuqi, ndërkaq në hapësirat e lira të bëhet mbjellja e drunjëve të lartë, hapësira të jetë e hapur për shfrytëzim të qytetarëve dhe studentëve të këtyre fakulteteve. Njëherit propozohet që të largohen parkingjet përgjatë objekteve të fakultetit ekonomik dhe e njëjta rrugë të shndërrohet në shteg për këmbësor dhe nevoja emergjente, kështu duke reduktuar lëvizjen e veturave brenda këtij kompleksi.

Kërkesat dhe peticionet të cilat kanë të bëjnë me ridestinimin e tërë hapësirës të trajtuar me planin rregullues të hollësishëm në park vlerësohen si të papranueshme për faktin që një kërkesë e tillë nuk është në harmoni me destinimin e planeve urbanistike në fuqi PZHK dhe PZHU.

Ndërsa kërkesat për ndërtimin e përmbajtjeve universitare në periferi të qytetit dhe të ngjajshme janë konsideruar si kërkesa jashtë kompetencave të këtij komisioni, të cilat mund të merren parasysh dhe të shqyrtohen gjatë hartimit të planeve urbane si PZHK dhe Hartë Zonale.

Propozimi i dal nga komisioni i dërgohet për shqyrtim bartësit të hartimit të Planit Rregullues të Hollësishëm - Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillim të Qëndrueshëm dhe ekipit hartues.

Komisioni nuk ka pajtueshmëri të plotë të të gjithë anëtarëve andaj pjesë e këtij raporti përveç arsytiveve të komisionit në vërejtjet e qytetarëve është edhe opinioni i anëtarit të këtij komisioni z. Ilir Gjinolli si përfaqësues i Universitetit dhe njëherit pjesë e ekipit hartues të propozim planit rregullues të hollësishëm.

#### KOMISIONI:

1. Muhamet Morina, kryesues, - DPSZHQ;







2. Ilir Gjinolli, anëtar, - Universiteti i Prishtinës

3. Flutra Gashi, anëtare, - Asoc.Ark.Kos;

4. Diellon Gjonbalaj, anëtar, - zyrtar ligjor

5. Selma Hyniler, anëtare, DPSZHQ;

6. Shyhrete Abazi, anëtare, - DPSZHQ;

  
\_\_\_\_\_  
  
\_\_\_\_\_  
  
\_\_\_\_\_  
  
\_\_\_\_\_  
  
\_\_\_\_\_  
  
\_\_\_\_\_



**Raporti i shqyrtimit të vërejtjeve dhe komenteve për Planin Rregullues të Hollësishtëm për "Zonën e Fakultetit Teknik, në lagjen Bregu i Diellit, sipas UA MMPH-Nr.05/2014 për përgjegjësitë e autoriteteve të Planifikimit hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapësinor si dhe sipas UA MAPL-NR.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në komuna,**

Nr.	Emri, mbiemri i parashtruesit	Vërejtje, propozim, sugjerim, kërkesë	Arsyeimi i grupit punues
1.	<p>Dren Shahini banore nag lagjia "Mati"</p> <p>Nr. personal 1171282604</p> <p>Nr. i telefonit: +38344500009</p>	<p>-Si banore i lagjes "Mati" nuk pajtohem aspak me planin e shfaqur për zonën tek fakulteti teknik Hapësira e gjelbert tek fakulteti teknik është fusha e veprime ku ne, banoret e disa lagjeve perreth e shfrytëzojmë për piknik familjar dhe rekreacion Lagjet "Ulpiana", "Bregu i Diellit" dhe sidomos "Mati"(Lagja e Spitallit) jane lagjet që këtë hapësirë e frekuentojnë më së shumeti.</p> <p>Ndërtimi betonimi i kesaj hapësire e demton rreth pamjen gjelberore dhe pamundeson shfrytëzimin e San dhe gasjen e lire!</p> <p>Gjithashtu kjo hapësire do të duhet të mbetet e lire edhe për shfaqje sigurie Në çfaredo ngjarje emergjente(tërmete etj) kjo fushë mund të përdoret për tubim të qytetarëve dhe hapje të cadrave(shatoreve)</p> <p>Ju lutem që këtë shqetesim ta konsideroni dhe sidomos hapësira për objektet e "FIEK + FIM" dhe "FIEK" objektet "T6" të mos ndërtohen!</p> <p>P.S Ka edhe shumë shqetesime tjera por kjo formë byrokratike po e pamundeson diskutimin e rregullit dhe qenesor.</p>	<p>Vlerësohet kërkesa e arsyeshme dhe propozohet dislokimi i objektit T6 – FIEK-ut në hapësirën përball objektit ekzistues – fakultetit Teknik duke plotësuar kriteret teknike sipas ligjeve dhe udhëzimeve administrative përkatëse në fuqi. Hapësira ku është planifikuar ndërtimi i FIEK-ut të mbetet hapësirë e lirë rekreative – park, e hapur për shfrytëzim nga ana e qytetarëve dhe studentëve të këtij kompleksi universitar.</p>

2.	<p><b>Artbër Ahmetaj</b></p> <p>-Kundershtiq ndertimin e objektit T6 arsye se kjo hapësirë është e vetmja lokacion , ku lagjet B, Diellit , L Spitalit e kanë të mundshme për qasje në hapësirë gjelbrore , sport , dhe rekreacion etj Vetem kjo hapësirë i ke shpëtuar ndertimit kaotik</p>	<p>Vlerësohet kërkesa e arsyeshme dhe propozohet dislokimi i objektit T6 – FIEK-ut në hapësirën përball objektit ekzistues – fakultetit Teknik duke plotësuar kriteret teknike sipas ligjeve dhe udhëzimeve administrative përkatëse në fuqi. Hapësira ku është planifikuar ndërtimi i FIEK-ut të mbetet hapësirë e lirë rekreative – park, e hapur për shfrytëzimin nga ana e qytetarëve dhe studentëve të këtij kompleksi universitar.</p>
3.	<p><b>Bedri Berisha</b></p> <p>Si banorë i lagjes "Matr 1" nuk pajtohem me projektin e ndertimeve tek fakulteti teknik , e posaqerisht kundershtoj fuqishem ndertimin e objektit "T6" , ku edhe ai pak gjelberim qe ka mbet në ate pjes po betonizohet. Kjo hapësirë "T6" duhet të mbetet park për shëtitje.</p>	<p>Vlerësohet kërkesa e arsyeshme dhe propozohet dislokimi i objektit T6 – FIEK-ut në hapësirën përball objektit ekzistues – fakultetit Teknik duke plotësuar kriteret teknike sipas ligjeve dhe udhëzimeve administrative përkatëse në fuqi. Hapësira ku është planifikuar ndërtimi i FIEK-ut të mbetet hapësirë e lirë rekreative – park, e hapur për shfrytëzimin nga ana e qytetarëve dhe studentëve të këtij kompleksi universitar.</p>
4.	<p><b>Bleron Limani</b></p> <p>Prishtinës i duhet jo një park i ri po shumë parqe të reja Ju lutem përdoren ndërgjegjën e pastër dhe mos lejoni betonizimin e pak gjelbërimit të mbetur në qytet. Bashkangjitur peticionet the votimet e më shumë se 1 500 qytetarëve për ndërtim të parkut të fakultetit teknik</p>	<p>Kuvendi i Komunës së Prishtinës me VENDIMI PËR FILLIMIN E HARTIMIT TË PLANIT RREGULLUES TË HOLLËSISHËM PË ZONËN TE FAKULTETI TEKNIK NË LAGJEN "BREGU I DIELLIT" 01-350/01-0026729/19 dt. 06.02.2019 me arsyetimin e vendimit ka inicuar hartimin e këtij plani rregullues të hollësishtëm me qëllim të adresimit të të gjitha kërkesave të Universitetit brenda kësaj hapësire.</p> <p>Kërkesa që e tërë hapësira që trajtohet me Planin rregullues të hollësishtëm të destinohet për park është në harmoni me planin urbanistikë ekzistues si PZHK dhe PZHU dhe një kërkesë e tillë është jashtë kompetencave të këtij komisioni.</p>

<p><b>5.</b></p> <p><b>Kushtrim Hoxha</b> Nr personal 1240120212 Nr kontaktues 049/113-152</p>	<p>-Tema Plani rregullues i hollësishëm për Zonën fakultetit teknik në lagjen Bregu i Diellit</p> <p>-Si qytetar i komunes të Prishtinës dhe banor i lagjes "Mati 1", si dhe inzhinjer i arkitektures i cili ka kryer hulumtime për zonën në shqyrtim, si dhe kam projektuar në projekt ideor në zonën për të cilën bëhet fjalë, ju propozoj të ndaloj degradimin e lokacionit dhe të ndërtoni hapësirat universitare në një zonë periferike si pjesë e kompleksit universitar të qasme për studentët, të bëhet planifikimi me një kohëzgjatje min. 100 vjeqare e kërkesave të studentëve dhe universitetit, dhe të projektohet ky kompleks Modern në kontekst URB-ARKITEKTONIK.</p> <p>Hapësirat e gjelbërta duhet të ruhen, duhet të shqyrtohet historiku dhe të ndërtohet një qender inovative multifunksionale e cila ndihmon mesimdhënjën dhe mesimnxënjen në të mirë të universitetit.</p>	<p>Kërkesa për ndërtimin e hapësirave universitare në periferi të qytetit konsiderojmë se është kërkesë jashtë kompetencave të këtij komisioni dhe është temë që mund të trajtohet me PZHK dhe Hartë Zonale.</p>
<p><b>6.</b></p> <p><b>Dr. Jashar Kabashi,</b> Nr. Lmj ID: 0466019 Sebahate Kabashi Nr. Lmj ID: 0466020</p>	<p>Kundershtoi fuqishtëm planin rregullues për zonën e fakultetit teknik, në lagjen "Bregu i Diellit". Ky projekt Apo plan rregullues është urbind(vrasje) urbanistike e kësaj hapësire të gjelbëruar për këte lagje dhe Prishtinën në përgjithësi. Kjo hapësirë e gjelbëruar është përdorur jo vetëm nga banorët e kësaj lagje por edhe nga shum shkolla fillore të Prishtinës si vend rekreacioni me vllë të tjerë. Për fat të keq, Prishtina është shkateruar nga një rrez të papërgjegjshëm, duke mos lënë pothuajse aspak hapësira të gjelbëruara apo hapësira të tjera për shkolla, qer dhe apo hapësira të tjera për aktivitete sportive apo rekreative.</p> <p>Një pjesë e madhe e pronave komunale janë zënë me objekte e ndërtesa banimi, duke mos menduar fare për institucione të rëndësishme kulturore, arsimore. Në vend të ndërtimit të këtyre objekteve, është mirë të rregullohet një park që do ta përdorim, jo vetëm qytetarët e kësaj lagjeje por edhe shum lagje të tjera të periferia.</p> <p>Fakultet e planifikuar për ndërtim mund të ndërtohen në lagjet periferike në drejtim të Pallatit të Drejtësisë ose në drejtim të Matiqanit dhe toka të tjera të lira në komunën e Prishtinës.</p> <p>Shpresojmë se Kuvendi Komunal i Prishtinës dhe Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të</p>	<p>Kundershtimi dhe kërkesa për ndërtimin e hapësirave universitare – fakulteteve në periferi të qytetit, të pallatit i Drejtësisë, konsiderojmë se janë kërkesa jashtë kompetencave të këtij komisioni.</p> <p>Këto tema mund të trajtohen gjatë hartimit të PZHK-së dhe Hartës Zonale.</p> <p>Tërheqja e vendimit për këtë plan rregullues të hollësishëm i përket Kuvendit Komunal.</p>

	<p>Qëndrueshëm do të mendojë dhe do të terheqë këtë Vendim për Planin Rregullues në zonën e Fakultetit Teknik në Prishtinë</p>	
<p><b>7.</b> <b>Bujar Prestreshi</b>, arkitekti</p>	<p>Verëjtje në shqyrtimin publik ndaj Planit Rregullues rreth Fakultetit Teknik</p> <p>Pas shikimit të Planit rregullues të propozuar për zonën rreth Fakultetit Teknik do të snpreh shkurtë mendimin tim si arkitekti dhe banor i lagjes Mati 1. Këndvështrimi im drejtohet të koncept plani i propozuar që ndikon të hapësira e gjelbëruar në juglindje nga ndërtesa e Fakultetit Teknik dhe jo të specifikat tjera dhe dytësore të tij</p> <p>Planin i propozuar ka së paku një problem jo të vogël por shumë lehtë i zgjidhshëm, sepse është afërsisht vetëm çerek pjesë e sipërfaqes në Planin e plotë të propozuar) Ky plan siq është ideuar përkeqëson hapësirën ekzistuese të gjelbëruar që tash sa vite përdoret për relaksim pushimin dhe aktivitetet fizike të banorëve të lagjes Mati 1, e Bregu i Drejllit dhe Ulpianës.</p> <p>Në këtë dokument hapësinor permendet se gjate punimit të planit të fizibilitetit janë konsultuar edhe grupet e interesit, por nuk permendet se cilat grupe ishin ato që ishin prezente në ato takime?</p> <p>E kuptoj nevojën për riutjen e hapësirave të Universitetit të Prishtinës, por ky lloj ndërtimi (investim publik) duhet të jete pajteter në harmoni me interesin publik. Interesi publik në këtë rast përveq zhvillimit të Arsimit publik është edhe ruajtja e hapësirës shumë të pakët cilësore të banorëve të rrethines ku po planifikohet të ndërtonet.</p> <p>Te gjithë banorët/çytetarët e Prishtinës e dinë shumë mire se aty në lindje dhe në jug të ndërtesës së Fakultetit Teknik ka një hapësirë të gjelbëruar që përdoret shumë dhe përdite nga banorët e lagjeve përreth</p>	<p>Vlerësohet kërkesa e arsyeshme dhe propozohet dislokimi i objektit T6 -- FIEK-ut në hapësirën përball objektit ekzistues -- fakultetit Teknik duke plotësuar kriteret teknike sipas ligjeve dhe udhëzimeve administrative përkatëse në fuqi.</p> <p>Hapësira ku është planifikuar ndërtimi i FIEK-ut të mbetet hapësirë e lirë rekreative -- park, e hapur për shfrytëzim nga ana e çytetarëve dhe studentëve të këtij kompleksi universitar.</p>



Ne një shtet demokratik investimet publike domosdoshmerisht duhet të kenaqin interesin e shumicës, e në këtë rast interesin e banorëve të L. Matit Bregu Diellit dhe Ulqinës(që mendoj se është pala e dytë më e rëndësishme e këtij grupi të interesit nuk është marrë parasysh) Edhe këta banorë janë takapagues dhe kontribues në financimin e projekteve arsimore dhe duhet të kenë ndikim në vendimet që e prekin mirëqenien e tyre. Pra vendimmarrja që nuk merr parasysh vullnetin e palëve të grupit të interesit është e kundërta e synimit të shoqërisë sone për ndërtimin e një shteti demokratik

Por sidoqoftë, përderisa ende Plani i Propozuar është në afatim e komentëve dhe ankesave nga palët e interesit, e shoh si shumë të lehtë ndryshimin e këtij Plani rregullues duke mos cenuar fare këte hapësirë shumë të rëndësishme për fëmijët dhe banorët e lagjeve perreth. Ky Plan rregullues Edhe pa preklencenimin e kësaj hapësire arrin mjaftueshem objektivat e veta me ndërtimet tjera të planifikuara në perëndim të ndërtesës së Fakultetit Teknik.

Në këtë plan u permenden edhe Planet e vjetra. Në kohën e tashme pothuajse nuk janë fare me rëndësi idetë e vitit 1975 për planifikimin e zones në fjalë, e sidomos kur dijme se prej pasluftës pothuajse asgjë nuk është planifikuar duke u bazuar në planet e kohës së para luftës 1999.

Çdo moment kohor i ka rethanat e veta reale, kështuqë hapësira e cila po shfrytëzohet nga banorët e rrethines ka kohë që ka krijuar identitetit e vet si hapësire publike për pushim, e aktivitet sportiv.

Në planifikim dhe dizajn urban mesojme dhe udhëzohet që hapësirat publike që krijohen identitet nga lëvizjet spontane të qytetarëve nuk ka nevojë të definohen fare nga arkitektet dhe urbanistët, sepse natyrisht ato kanë gjetur menyrën e funksionimit me të mirë. Kjo hapësire mund të permiresohet me gjelbërim të lartë për hije por jo me ndërtim të ri.

Prandaj si përfundim mendoj se ky Plan rregullues nuk përmban asnjë arsyeim të mirëfillte apo planifikim racional / logjik për sipërfaqen ku propozon zhdukjen e identitetit ekzistues të hapësirës së cekur

	<p>(Ky Plan propozon që mbi më shumë se gjysmen e hapësirës së gjetëbuar në fjalë të ndërtohet me një godinë 7 katëshe , e cila e përkeqëson përfundimisht dhe plotësisht këtë hapësirë pushimi) Këtu nuk ka nevojë fare për riorganizim apo zvogelim të sipërfaqes së gjetëbërimit</p> <p>Ju lutem ta konsideroni mendimin tim sepse mendim të ngjajshëm kanë edhe banorët e lagjeve që përmenda</p> <p>Për gjyken ndaj brengës sime mund të ma shkruani të <a href="mailto:buljarprestresh@gmail.com">buljarprestresh@gmail.com</a></p> <p>Bashkangjitur me postë janë dy imazhe që paraqesin sipërfaqën e ndikuar nga Plani i propozuar rregullues</p>	
<p><b>8.</b></p> <p>(Petition elektronik) Duam park te hapësira pranë F. Teknik, jo beton të Teatrit të Operës</p>	<p>Pas lajmit se 4 kompani janë duke gatur për projektimin e Teatrit të Operës , të datës 9 Gusht 2019 , e pamë si obligim të veprimjeve në të mirën e qytetit tone</p> <p>Ne si qytetar të Prishtinës e përkrahim Teatrin e Operës si institucion të rëndësishëm kulturor , por jo ndërtimin e objektit në at pak gjetëbërime që ka mbet në këtë pjesë të qytetit</p> <p>Kjo hapësirë është duke u përdorur si park nag miqëria qytetar të Prishtinës , posaçërisht nga lagjet Mat i , Bregu i Diellit , dhe Ulpiana.</p> <p>Andaj kërkojmë nga Komuna e Prishtinës dhe të gjitha partitë politike të përfqësuar në Kuvendin Komunal të Prishtinës , që kjo hapësirë të rridesinohet si Park dhe të rregullohet/adaptohet si e tillë.</p> <p>Ky petition është iniciativë e qytetarëve të Prishtinës dhe si i tillë</p> <p>(Këtu petitioni i është bashkangjitur një fletë e votimeve elektronike)</p>	<p>Plani Rregullues i Hollësishtëm për "Zonën e Fakultetit Teknik, në lagjen Bregu i Diellit" nuk ka të bëjë me ndërtimin e teatrit dhe operës.</p> <p>Kërkesa që e tërë hapësira që trajtohet me Planin rregullues të hollësishtëm të rridesinohet për park nuk është në harmoni me planet urbanistike ekzistuese si PZHK dhe PZHU dhe një kërkesë e tillë është jashtë kompetencave të këtij komisioni.</p> <p>Kërkesa për rridesinim të kësaj hapësire mund të trajtohet gjatë hartimit të PZHK-së dhe Hartës Zonale.</p>

Për: Komisioni për shqyrtimin e vërejtjeve dhe ankesave të qytetarëve gjatë procesit të shqyrtimit të PRRH Zona e Fakultetit Teknik në Bregun e Diellit

Nga: Ilir GJINOLLI – anëtar i Komisionit

## Opinion në lidhje me vërejtjet dhe ankesat e qytetarëve

Ky opinion nuk është subjektiv, por bazohet në argumente të cilat janë në ligje dhe rregullore si dhe në procesin e planifikimit të drejtuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës. Ai bazohet edhe në kodin profesional si urbanist duke konsideruar interesin publik mbi interesin e ngushtë individual apo grupor. Arsimi universitar është funksion publik, ndërkaq, Universiteti i Prishtinës, si entitet i arsimit publik, ka një rol historik në zhvillimin e Kosovës që nga themelimi i tij në vitet 60 të shekullit të kaluar.

Meqenëse shumica e kërkesave gjatë shqyrtimit publik janë për mos ndërtim ose për heqjen ose zhvendosjen e lokacionit të zgjerimit të fakulteteve teknike nga tërësia T6, me poshtë do të paraqes mendimin tim të mbështetur nga ekipi planifikues dhe nga rektorati i Universitetit të Prishtinës:

1. Baza ligjore: Sa i përket kërkesave që në këtë zonë të mos ndërtohet të Kampusit Tekniku dhe lënia e sipërfaqes si të tillë, një kërkesë e tillë nuk ka bazë ligjore për shkak se propozimi i PRRH është hartuar në bazë të vendimit të Komunës 01-350/01 - 00267 29/19. datë 06. 02.2019 i miratuar në Kuvendin e Komunës në bazë të Studimit të fizibilitetit të hartuar nga Katedra së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor të Fakultetit të Arkitekturës, Universiteti i Prishtinës. Në fazën në të cilën është plani dhe procesit të miratimit, kjo kërkesë është e pabazë.
2. PRRH Zona e Fakultetit Teknik është hartuar në bazë të studimit të fizibilitetit të miratuar në Kuvendin e Komunës. Studimi i fizibilitetit është nisur nga Strategjia e Universitetit të Prishtinës ku njeri prej çaqeve është zgjerimi i hapësirave të Universitetit të Prishtinës si bazë për ngritjen e kualitetit të studimeve. Fizibiliteti është nxitur sidomos bazuar në nevojat emergjente për hapësirë të disa fakulteteve ku mungesa e hapësirës për një kohë të gjatë është reflektuar në kualitetin e studimeve. Propozimi i programeve për zgjerimin e hapësirave të fakulteteve të cilat do të vendosen në këtë zonë, është bazuar në projeksion e numrit të studentëve dhe profileve specifike që do të ofrohen nëpër fakultetet respektive. Dhe kjo sipërfaqe ka shërbyer si bazë për dimensionimin e hapësirave të ndërtuara në propozim planin. Sipas Studimit të Fizibilitetit, propozimi origjinal i aprovuar në kuvend ka pasë indeksin e shputës 32%. Pikërisht për shkak të publikut ai është zvogëluar në 27%.
3. Hartimi i PRRH është bërë në bazë të ligjeve dhe udhëzimeve administrative në fuqi e në veçanti:
  - UDHËZIM ADMINISTRATIV MMPH - Nr.01/2018 PËR ELEMENTET DHE KËRKESAT THEMELORE PËR HARTIMIN, ZBATIMIN DHE MONITORIMIN E PLANEVE RREGULLUESE TË HOLLËSISHME
  - UDHËZIM ADMINISTRATIV MMPH-NR.08/2017 MBI NORMAT TEKNIKE TË PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

Të gjitha përmbajtjet e ndërtuara dhe sipërfaqet e hapësirave publike i nënshtrohen këtyre standardeve pa përjashtim, prandaj sa i përket ligjshmërisë nuk ka bazë për kundërshtim.

4. Në lidhje me kërkesën për mos-ndërtimin ose zhvendosjen e ndërtesës së re të fakulteteve teknike nga tërësia T6 dhe kërkesës që hapësira të jetë hapësirë publike e gjelbëruar për banorët e lagjeve përreth: Ulpiana, Bregu i Diellit dhe Mati, kërkesa është po ashtu e paargumentuar. Lagjet Ulpiana dhe Bregu i Diellit janë lagje të planifikuara në vitet 60 dhe 70 të shekullit të kaluar dhe sipërfaqet e gjelbra në këto lagje i tejkalojnë standardet sa i përket madhësisë së sipërfaqeve të tyre. Edhe ashtu, kërkesat janë kryesisht të banorëve të lagjes Mati të cilët kanë mungesë të hapësirave të gjelbra. Hartuesit gjatë procesit të planifikimit, në konsultim edhe me autoritetet e UP, e kanë konsideruar këtë fakt dhe koncepti i "Kampusit të Hapur" në mënyrë të qartë e thekson hapjen e tërë zonës ndaj publikut. Respektimi i interesit të publikut mbështetet me sigurimin e afërsisht 6 ha sipërfaqe publike të kombinuara - gjelbërim dhe pllakosje si dhe me ofrimin e mundësive për aktivitetet të ndryshme në hapësirën publike: ecje, vrapim, çiklizëm, lojëra formale dhe jo formale, lojra për fëmijë si dhe ngjarje e manifestime të ndryshme.

Asnjë nga kërkesat cekura e qytetarëve nuk mbështetet me argument siç janë:

- E drejta për shfrytëzim të hapësirës - sepse plani nuk vendosë kurrfarë regjimi të shfrytëzimit, por përkundrazi është tërësisht i hapur për publikun
- Standardet e sipërfaqeve të lira në relacion me sipërfaqen e ndërtuar të përcaktuara me UDHËZIM ADMINISTRATIV MMPH-NR.08/2017 MBI NORMAT TEKNIKE TË PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

5. Ekipi hartues ka analizuar propozimin për zhvendosjen e ndërtesës së re të fakulteteve teknike nga tërësia T6 në lokacionin pranë ndërtesës ekzistuese të fakulteteve teknike. Përfundimi është se dislokimi në këtë lokacion është joadekuat për këto arsye:
  - Lokacioni jo i mjaftueshëm - Pamundësia e rritjes së hapësirës për publike
  - Distanca e vogël nga ndërtesa ekzistuese në perëndim dhe lagja e Universiteti në lindje
  - Topografia jo adekuate

Çështjen e dislokimit të ndërtesës së re të fakulteteve teknike e kemi diskutuar edhe me autoritetet e UP dhe edhe ata nuk e kanë miratuar si propozim të mundshëm.

Nisur nga interesi publik që përfaqëson Universiteti i Prishtinës dhe mungesa e hapësirës kualitative të studimeve ka ndikim të madh në kualitetin e studimeve, si profesionistë të hapësirës jemi të ndjeshëm, kur në mënyrë të paargumentuar parashtrohen kërkesa të cilat ky propozim plan i ka marrë parasysh në tërësi. Zona e Fakultetit Teknik nuk mund t'i plotësojë mungesat e hapësirave të gjelbra të cilat janë theksuar me zhvillimin e pasluftës në Prishtinë, thjeshtë sepse nuk ka kapacitet dhe për shkak se është larg zonave të banimit nga të cilat kanë ardhur kërkesat e qytetarëve.

Për njërin prej qytetarëve, më i rëndësishëm është pikniku se përparimi i studimeve në Universitetin e Prishtinës. Po, pikniku është i rëndësishëm, por ai nuk zhvillohet në qendër të qytetit. Për këtë e kemi Parkun e Gërmisë si një pasuri natyrore që shumë qytete nuk e kanë.